

VENDIM
Nr. 150, datë 21.3.1997

PËR KALIMIN NË LIKUIDIM TË NDËRMARRJES SË FLOTËS DETARE TREGTARE NË DURRES

Me propozimin e Ministrisë së Privatizimeve dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit e Tregtisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të shpallë falimentimin dhe të autorizojë fillimin e procedurave të likuidimit të ndërmarrjes së Flotës Detare Tregtare në Durrës.
2. Procedurat e likuidimit kryhen në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.620, datë 16.9.1996, nga Ministria e Privatizimeve.
3. Porti detar në Durrës do të japë në përdorim të likuidatorëve të Flotës Detare Tregtare një zyrë dhe do të mbulojë pagat e tyre gjatë periudhës së likuidimit.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.86, datë 12.2.1996, shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Privatizimeve dhe Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino